



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
REKTORI

Nr. 1378 Prot

Shkodër, më 22 . 04 .2024

Lënda: Publikim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

**AGJENSISË SË PROKURIMIT PUBLIK**

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletinin e Njoftimeve Publike të rradhës për një vend pune.  
Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.

REKTORI  
Prof.dr. **Rajmonda Këçica**



REPUBLIKA E SHQIPERISE

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"  
REKTORI

Nr. 1378 Prot

Shkodër, më 22 09 2024

**N J O F T I M**

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit, Departamenti i Arteve, në pozicionin asistent-lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2023-2024, programi i studimit "Pikturë dhe grafikë", për lëndët "Aplikime dixhitale për artet pamore", "Fotografi" dhe "Fotografi dixhitale".

**Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere specifike :**

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e studimit në fushen e arteve pamore, në sistemin me kohë të plotë.
2. Të kenë kryer ciklin e parë të studimeve në fushen e arteve pamore (preferohet në specialitetin Multimedia ose specialitete të ngjashme) me notë mesatare jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) kurse nota mesatare e lëndëve për të cilat konkurrohet duhet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë). Kandidati që konkurren duhet ti ketë dhënë domosdoshmërisht provim lëndët për të cilat pretendon të jetë mësimdhënës.
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar) në specialitetin Multimedia duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve ku përfshihet lënda për të cilën konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
4. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, me notë jo më të ulët se 8 (tetë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose të njohur nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
5. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë.
6. Të kenë botime dhe/ose aktivitete artistike, i cili pikëzohet sipas kritereve të miratuara në Departament :

Vlerësohen me një pikë : pjesëmarrje kolektive në galeri jopublike, kloloni, simpoziume,  
Vlerësohen me dy pikë : ekspozita personale në galeri jopublike, pjesëmarrje kolektive në galeri publike,  
Vlerësohen me pesë pikë : ekspozita kolektive ndërkombëtare, ekspozita personale në galeri publike, biennale, rezidenca, çmime kombëtare në aktivitete të njohura,  
Vlerësohen me dhjetë pikë : ekspozita personale në galeri kombëtare dhe ndërkombëtare, çmime ndërkombëtare.

**Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :**

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.

2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
7. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjtes njësi bazë/drejtorisë ku kërkojnë të punësohen.

**Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :**

1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresen [www.unishk.edu.al](http://www.unishk.edu.al) (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brëndshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose titujve akademikë (nëse ka të tilla).
5. Dy rekomandime nga të cilat të paktën një prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekomandim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferenca, seminare, ërkshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përmbartimit)
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë + certifikatë vaksinimi anti-Covid)
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencën e banimit (kontratë qiramarrje).

**Shënim :**

- Kontrata e punës do të jetë me afat 1 – vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë ose pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përmbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njoftimit në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njoftimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njoftohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë, të drejtshkoni dekanatit përkatës dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

**R E K T O R I**  
**Prof. dr. Rajmonda KËÇIRA**